



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2303/4 prot.

Datë 12.10.2023

V E N D I M
Nr. 1037 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnim Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.10.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me kushte të përcaktuara”, me nr. REF-74531-07-07-2023, me objekt “Loti 3: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II”, Loti 3: Ref- 74541-07-07-2023, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 Lek pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, kjo vlerë konvertohet në 791,089.16 Euro, zhvilluar në datën 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: Operator ekonomik “LIQENI VII” SHPK me NIPT K01730502W dhe me adresë Rruga “Dituria”, Zona kadastrale nr. 8516, Nr. Pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozet, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë Rr. “Sami Frashëri”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.07.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshjes kuadër me disa operatorë ekonomik me kushtet të përcaktuara”, me nr. REF-74531-07-07-2023, me objekt “Loti 3: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të

kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II”, Loti 3: Ref-74541-07-07-2023, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 Lek pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 791,089.16 Euro, zhvilluar në datën 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 10.08.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 13.09.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “A R J E I L” SHPK	69,146,950 lekë, Kualifikuar
2. “LIQENI VII” SHPK	66,000,000 lekë, Skualifikuar
3. “LIGUS” SHPK	66,504,200 lekë, Skualifikuar
4. “VIBTIS” SHPK	68,833,336 lekë, Skualifikuar
5. “HTM” SHPK	75,036,256 lekë, Skualifikuar
6. “CURRI” SHPK	73,236,795 lekë, Skualifikuar

II.4. Në datën 19.09.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 80, datë 25.09.2023.

II.5. Në datën 20.09.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3434 dhe me nr. 2303/2023 prot., datë 20.09.2023 e operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “LIQENI VII” SHPK. Pretendimet janë si më poshtë vijon:

“Sa i perket pjeses se pare te pretendimit tuaj “Faturat e paraqitura nga OE LIQENI VII nuk jane kontrata furnizime mallrash (lende e pare) me natyre te ngjashme, por jane kontrata punimesh ndertimore me objekt “Rikonstruksion i rrjetit ekzistues te qytetit te Durrës, zona 14, Bashkia Durrës” ; “Ndertim KUN ne rrugen Shebeniku, Laknas L412 ml fi=315mm; i Punime ne objektin “Permiresimi i furnizimit me uje Lagjja Nr. 1, Vadardhe, Njesia Administrative Sukth Bashkia Durrës” te cilat nuk perputhen me kerkesen e autoriteti kontraktor lidhur me kete pike” kundershtojme si me poshte:

ARGUMENTI NR 1:

Ne dokumentin standard te tenderit, kriteri paraqitet si vijon citojme “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e

vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë..vijon”

Sikurse percaktohet qarte nga kriteri i cituar me siper, ju keni kerkuar deshmi per furnizime te meparshme te ngjashme dhe jo domosdoshmerisht kontrata furnizimi. Kontratat qe ne kemi paraqitur jane kontrata te cilat permbajne pervecse furnizim materialesh, edhe vendosjen e tyre ne objekt. Mendojme dhe besojme se ky eshte nje fakt qe kompanine tone e ben akoma me te kualifikuar pasi tregon se jo vetem mund te blejme dhe transportojme nje material dhe ta dergojme ne destinacion por jemi te kualifikuar dhe ta vendosim ose montojme gjithashtu ne objekt.

Megjithate, ndonese ne pjesen e pare te pretendimit jeni shprehur se duke qene se kemi paraqitur kontrate zbatimi nuk e plotesojme kriterin e “furnizimeve te ngjashme” ne fakt ne pjesen e dyte te pretendimit keni pranuar se keni perlllogaritur pjesen e “furnizimeve” ne keto kontrata zbatimi dhe serish nuk e plotesojne vleren e punes se ngjashme te kerkuar ne tender (40% e fondit limit). Ne fjale te tjera, pasi nuk keni pranuar se keto kontrata jane te ngjashme, ne fakt i keni konsideruar dhe perlllogaritur duke ardhur keshtu ne kundershkrimin tone te dyte i cili vijon me poshte. Vijon: “Konkretisht, edhe pse kontratat e paraqitura nga ky operator si pune te ngjashme jane kontrata punimesh dhe jo kontrata furnizimesh, AK shqyrtoi vleren e furnizimeve per keto kontratat dhe ne perfundim vleresoi se keto furnizime te cilat jane paraqitur dhe plotesojne kriterin e afatit 3 vjeçar (gjate tre viteve te fundit) nuk e arrijne vleren e 40% te fondit limit, sikurse percaktuar ne piken 2.3.1 te Dokumenteve Standarde te tenderit (loti 3)” kundershtojme si me poshte:

Shoqeria jone ju paraqet bashkengjitur me kete ankese nje pasqyre permbledhese te titulluar “Pasqyre permbledhese faturat e materialeve hidraulike te blera per punet e ngjashme te paraqitura 1-9” e cila paraqet ne sasi dhe vlere materialet e blera nga ana jone nga momenti i lidhjesse kontratave deri ne perfundim te tyre. Kjo pasqyre tregon se vlere e furnizimeve qe ne kemi marre per ta shitur me pas tek klientet tane per keto tre objekte, eshte dukshem me e madhe se vlere e punimeve te ngjashme qe ju kerkoni.

ARGUMENTI NR 2

Ne kemi bere nje analize te hollesishme per cdo ze te situacionit perfundimtar bazuar ne analizat emanalit te cmimeve te ndertimit. Nga zberthimi i zerave te materialeve hidraulike sipas analizave te manualit te cmimeve te ndertimit dhe analizave te projektuesve te objekteve, duke i zhveshur keto analiza nga zerat puntori, makineri etj. dhe duke lene vetem zerin materiale + 5% shpenzime plotesuese dhe + 8 % fitimi arrihet vlere per punen e ngjashme sipas dokumentit me emertimin “Tabela e puneve te ngjashme te paraqitura” bashkengjitur me kete ankese.

Keto tabela kundershtojne ne menyre teknike pretendimin tuaj se “LIQENI VII” sh.p.k nuk ploteson vleren e punes se ngjashme te kerkuar dhe sikurse verejme, Shoqeria jone e ploteson dhe e tejkalon vleren e punes se ngjashme te kerkuar vetem me objektin “Rikonstruksion i rrjetit ekzistues te qytetit te Durresit, zona 14, Bashkia Durres”. Megjithate, edhe pa u futur ne perlllogaritje teknike te hollesishme, nisur edhe nga pervoja jone praktike nuk ka asnje mundesi qe zeri “material “ te zere me pak se 35%-40 % te vleres totale te situacionit perfundimtar ndaj automatikisht nese vlere e objektit “Rikonstruksion i rrjetit ekzistues te qytetit te Durresit, zona 14, Bashkia Durres” te kryer 100% nga LIQENI

VII shpk ka vleren 195,294,902 Leke, eshte lehtesisht e kuptueshme se "LIQENI VII" sh.p.k jo vetem e ploteson vleren e punes se ngjashme te kerkuar (33,333,333.2 Leke pa T.V.Sh) por e tejkalon edhe me dyfish ate vetem me kete objekt dhe gjithashtu e marre se bashku e tejkalon shume, me teper edhe per objektet e deklaruar si pune te ngjashme marre ne raport me % e ndarjes se operatoreve ekonomike sipas kontratave respektive.

Bashkengjitur me kete ankese gjithashtu do te gjeni Analizat Teknike per secilin objekt sipas manualeve te ndertimit si dhe Analizat Teknike sipas projektueseve te objekteve te zhveshura nga cdo ze tjeter pervec zerit material dhe shpenzimeve plotesuese e fitimit te shoqerise.

ARGUMENTI NR 3

Sa me siper, nuk duam te mendojme se skualifikimi eshte bere ne menyre selektive por e konsiderojme te parregullt skualifikimin pasi ne kemi konkurruar ne dy lote ne te njejtin ent prokurues ne te njejten date dhe te njejten ore tenderi, dhe nga nje gabim njerezor kemi ngarkuar vetem tek njera procedure kontraten e furnizimit qe ne kemi realizuar me Ministrine e Mbrojtjes me objekt "Blerje materiale per mirembajtte te pergjithshme" e cila eshte thjesht kontrate furnizimi dhe mbulon gjithashtu me shume se 75% te kerkeses Tuaj per pune te ngjashme te cilen gjithashtu do ta gjeni bashkengjitur me kete ankese-dokumenti me titullin "Ministria e Mbrojtjes -Blerje materiale per mirembajtte te pergjithshme".

Ne kete rast do kerkonim qe nese nga ana Juaj do te kerkohet te merret pershtypje sa me e mire ne profesionalizmin e treguar gjate vleresimit te ketyre procedurave dhe nese keni interes real te mesoni sa me shume rreth reputacionit te konkurreseve, nuk do te kishte asgje te keqe qe kete gabim njerezor ne kete rast ta korigjoni vete ju dhe ta merrni ne konsiderate ekzistencen e asaj kontrate furnizimi te kryer nga LIQENI VII shpk te bashkengjitur ne proceduren "Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët-materiale elektrike lëndë e parë Faza II" qe eshte kryer nga ana juaj sic e percaktuam me lart ne te njejten dite dhe ore . E kerkojme kete jo per t'ju shtyre juve te dyshoni se LIQENI VII sh.p.k nuk ploteson punet e ngjashme me kontratat e paraqitura por ne fakt per te rritur bindjen e autoritetit tuaj ne pervojen e shoqerise tone.

Mendojme se argumenti me siper eshte e bazuar edhe ne Ligji per Prokurimin Publik Nr. 162/2020 , neni 92 i cili thekson se autoriteti kontrator (Investitori) mund te kerkoje nga konkurrentet ne gare sqarime dhe plotesime dokumentacioni qe nuk prek ne thelb oferten.

Ky pretendim vjen edhe nga fakti qe ju nuk e keni marre parasysh kete kontrate furnizimi as tek procedura perkatese ku ne e kemi bashkengjitur ne sistem pra "Loti 2: "Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II" duke bere keshtu nje skualifikim krejt te pa bazuar pa i marre ne konsiderate e studiuar si duhet te gjitha kontrata e puneve te ngjashme te paraqitura ne tender.

Bashkengjitur me kete ankese nisim kontraten e furnizimit "Blerje material per mirembajtje te pergjithshme" sepse tregon eskperienca tone te gjere si operator ekonomik ndonese ne serish i qendrojme mendimit se nje kompani qe jo vetem furnizon por edhe monton ne objekt materialet eshte shume me e kualifikuar se nje kompani qe kryen vetem furnizimin.

Se fundmi ne mbetemi ne dispozicion te Autoritetit Kontraktor dhe te Komisionit te

Prokurimit Publik te gatshem per te sjelle cdo dokument apo argument tjeter qe mund te kerkohet nga ana juaj me qellim qe ju te krijoni bindjen e plote se skualifikimi eshte i padrejte duke kerkuar keshtu kualifikimin e shoqerise LIQENI VII sh.p.k ne te dyja procedurat si Loti 2, ashtu edhe Loti 3: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II” me Autoritet Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2303/2 prot., 21.09.2023 arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Me anë të shkresës Nr. 3100/2 prot., datë 25.09.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 2303/3 prot., datë 27.09.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “[...]Sa i perket pjeses se pare te pretendimit tuaj “Faturat e paraqitura nga OE LIQENI VII nuk jane kontrata furnizime mallrash (lende e pare) me natyre te ngjashme, por jane kontrata punimesh ndertimore me objekt “Rikonstruksion i rrjetit ekzistues te qytetit te Durrës, zona 14, Bashkia Durrës” ; “Ndertim KUN ne rrugen Shebeniku, Laknas L412 ml fi=315mm; i Punime ne objektin “Permiresimi i furnizimit me uje Lagjja Nr. 1, Vadardhe, Njesia Administrative Sukth Bashkia Durrës” te cilat nuk perputhen me kerkesen e autoriteti kontraktor lidhur me kete pike” kundërshtojme si me poshte:

ARGUMENTI NR 1:

Ne dokumentin standard te tenderit, kriteri paraqitet si vijon citojme “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë..vijon”

Sikurse percaktohet qarte nga kriteri i cituar me siper, ju keni kerkuar deshmi per furnizime te meparshme te ngjashme dhe jo domosdoshmerisht kontrata furnizimi. Kontratat qe ne kemi paraqitur jane kontrata te cilat permbajne pervecse furnizim materialesh, edhe vendosjen e tyre ne objekt. Mendojme dhe besojme se ky eshte nje fakt qe kompanine tone e ben akoma me te kualifikuar pasi tregon se jo vetem mund te blejme dhe transportojme nje material dhe ta dergojme ne destinacion por jemi te kualifikuar dhe ta vendosim ose montojme gjithashtu ne objekt.

Megjithate, ndonese ne pjesen e pare te pretendimit jeni shprehur se duke qene se kemi paraqitur kontrate zbatimi nuk e plotesojme kriterin e “furnizimeve te ngjashme” ne fakt ne pjesen e dyte te pretendimit keni pranuar se keni perlllogaritur pjesen e “furnizimeve” ne keto kontrata zbatimi dhe serish nuk e plotesojne vleren e punes se ngjashme te kerkuar ne tender (40% e fondit limit). Ne fjale te tjera, pasi nuk keni pranuar se keto kontrata jane te ngjashme, ne fakt i keni konsideruar dhe perlllogaritur duke ardhur keshtu ne kundershimin tone te dyte I cili vijon meposhte. Vijon: “Konkretisht, edhe pse kontratat e paraqitura nga ky operator si pune te ngjashme jane kontrata punimesh dhe jo kontrata furnizimesh, AK shqyrtoi vleren e furnizimeve per keto kontrata dhe ne perfundim vleresoi se keto furnizime te cilat jane paraqitur dhe plotesojne kriterin e afatit 3 vjecar (gjate tre viteve te fundit) nuk e arrijne vleren e 40% te fondit limit, sikurse percaktuar ne piken 2.3.1 te Dokumenteve Standarde te tenderit (loti 3)” kundershtojme si me poshte:

Shoqeria jone ju paraqet bashkengjitur me kete ankese nje pasqyre permbledhese te titulluar “Pasqyre permbledhese faturat e materialeve hidraulike te blera per punet e ngjashme te paraqitura1-9” e cila paraqet ne sasi dhe vlere materialet e blera nga ana jone nga momenti i lidhjesse kontratave deri ne perfundim te tyre. Kjo pasqyre tregon se vlera e furnizimeve qe ne kemi marre per ta shitur me pas tek klientet tane per keto tre objekte, eshte dukshem me e madhe se vlera e punimeve te ngjashme qe ju kerkoni.

ARGUMENTI NR 2

Ne kemi bere nje analize te hollesishme per cdo ze te situacionit perfundimtar bazuar ne analizat emanalit te cmimeve te ndertimit. Nga zberthimi i zerave te materialeve hidraulike sipas analizave te manualit te cmimeve te ndertimit dhe analizave te projektuesve te objekteve, duke i zhveshur keto analiza nga zerat puntori, makineri etj. dhe duke lene vetem zerin materiale + 5% shpenzime plotesuese dhe + 8 % fitimi arrihet vlera per punen e ngjashme sipas dokumentit me emertimin “Tabela e puneve te ngjashme te paraqitura” bashkengjitur me kete ankese.

Keto tabela kundershtojne ne menyre teknike pretendimin tuaj se “LIQENI VII” sh.p.k nuk ploteson vleren e punes se ngjashme te kerkuar dhe sikurse verejme, Shoqeria jone e

ploteson dhe e tejkalon vleren e punes se ngjashme te kerkuar vetem me objektin "Rikonstruksion i rrjetit ekzistues te qytetit te Durrës, zona 14, Bashkia Durrës". Megjithate, edhe pa u futur ne perlllogaritje teknike te hollesishme, nisur edhe nga pervoja jone praktike nuk ka asnje mundesi qe zeri "material " te zere me pak se 35%-40 % te vleres totale te situacionit perfundimtar ndaj automatikisht nese vlera e objektit "Rikonstruksion i rrjetit ekzistues te qytetit te Durrës, zona 14, Bashkia Durrës" te kryer 100% nga LIQENI VII shpk ka vleren 195,294,902 Leke, eshte lehtësisht e kuptueshme se "LIQENI VII" sh.p.k jo vetem e ploteson vleren e punes se ngjashme te kerkuar (33,333,333.2 Leke pa TVSh) por e tejkalon edhe me dyfish ate vetem me kete objekt dhe gjithashtu e marre se bashku e tejkalon shume, me teper edhe per objektet e deklaruar si pune te ngjashme marre ne raport me % e ndarjes se operatoreve ekonomike sipas kontratave respektive.

Bashkengjitur me kete ankese gjithashtu do te gjeni Analizat Teknike per secilin objekt sipas manualeve te ndertimit si dhe Analizat Teknike sipas projektueseve te objekteve te zhveshura ngacdo ze tjeter pervec zerit material dhe shpenzimeve plotesuese e fitimit te shoqerise.

ARGUMENTI NR 3

Sa me siper, nuk duam te mendojme se skualifikimi eshte bere ne menyre selektive por e konsiderojme te parregullt skualifikimin pasi ne kemi konkuruar ne dy lote ne te njejtin ent prokurues ne te njejten date dhe te njejten ore tenderi, dhe nga nje gabim njerezor kemi ngarkuar vetem tek njera procedure kontraten e furnizimit qe ne kemi realizuar me Ministrine e Mbrojtjes me objekt "Blerje materiale per mirembajte te pergjithshme" e cila eshte thjesht kontrate furnizimi dhe mbulon gjithashtu me shume se 75% te kerkeses Tuaj per pune te ngjashme te cilen gjithashtu do ta gjeni bashkengjitur me kete ankese-dokumenti me titullin "Ministria e Mbrojtjes -Blerje materiale per mirembajte te pergjithshme".

Ne kete rast do kerkonim qe nese nga ana Juaj do te kerkohet te merret pershtypje sa me e mire ne profesionalizmin e treguar gjate vleresimit te ketyre procedurave dhe nese keni interes real te mesoni sa me shume rreth reputacionit te konkureseseve, nuk do te kishte asgje te keqe qe kete gabim njerezor ne kete rast ta korigjoni vete ju dhe ta merrni ne konsiderate ekzistencen e asaj kontrate furnizimi te kryer nga LIQENI VII shpk te bashkengjitur ne proceduren "Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët-materiale elektrike lëndë e parë Faza II" qe eshte kryer nga ana juaj sic e percaktuam me lart ne tenjejtin dite dhe ore . E kerkojme kete jo per t'ju shtyre juve te dyshoni se LIQENI VII sh.p.k nuk ploteson punet e ngjashme me kontratat e paraqitura por ne fakt per te rritur bindjen e autoritetit tuaj ne pervojen e shoqerise tone.

Mendojme se argumenti mesiper eshte e bazuar edhe ne Ligji per Prokurimin Publik Nr 162/2020 , neni 92 i cili thekson se autoriteti kontrator (Investitori) mund te kerkoje nga konkurentet ne gare sqarime dhe plotesime dokumentacioni qe nuk prek ne thelb oferten.

Ky pretendim vjen edhe nga fakti qe ju nuk e keni marre parasysh kete kontrate furnizimi as tek procedura perkatese ku ne e kemi bashkengjitur ne sistem pra "Loti 2: "Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II" duke bere kështu nje skualifikim krejt te pa bazuar pa i marre ne konsiderate e studiuar si duhet te gjitha kontrata e puneve te

ngjashme te paraqitura ne tender.

Bashkengjitur me kete ankese nisim kontraten e furnizimit “Blerje material per mirembajtje te pergjithshme” sepse tregon eskperiencon tone te gjere si operator ekonomik ndonese ne serish i qendrojme mendimit se nje kompani qe jo vetem furnizon por edhe monton ne objekt materialesteshte shume me e kualifikuar se nje kompani qe kryen vetem furnizimin.

Se fundmi ne mbetemi ne dispozicion te Autoritetit Kontraktor dhe te Komisionit te Prokurimit Publik te gatshem per te sjelle cdo dokument apo argument tjetër qe mund te kerkohet nga ana juaj me qellim qe ju te krijoni bindjen e plote se skualifikimi eshte i padrejte duke kerkuar keshtu kualifikimin e shoqerise LIQENI VII sh.p.k ne te dyja procedurat si Loti 2, ashtu edhe Loti 3: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II” me Autoritet Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në lotin 3, shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

I. Specifikime teknike (Materiale për Ujësjellës kanalizime)

Materiale per ujesjelles kanalizime

Tuba plastik HDPE 100

Tubat duhet të jenë PE 100-RC për ujë të pijshëm dhe në përputhje me DIN 8074/8075, DIN EN 12201 për instalime ne kanale pa shtrat rëre, të prodhuar me PE 100-RC me rezistencën më të lartë ndaj plasaritjeve të ngadalta (FNCT kërkesat minimale: ≥ 8760 h në përputhje me PAS 1075; $T=80^{\circ}\text{C}$, $\sigma=4$ N/mm², 2% Arkopal), të verifikuara ne përputhje me të dyja DIN 8075 dhe DVGË GË 335 A2.

Etiketimi i tubave të bëhen me lazer, duke përfshirë barkodin e gjurmueshmërisë së tipit 128-C, në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt mbi tub.

Tubat duhet të kenë miratime të përditësuara sipas PAS 1075, DVGË dhe EN 12201 të cilat Kontraktori do t'ia paraqesë Mbikëqyrësit.

Tubat me diametër deri në 63 mm duhet të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 1, tuba me mure të ngurtë me një shtresë të prodhuar me PE100-RC ose në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat me diametër të barabartë dhe më të madhe se 75 mm do të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat sipas PAS 1075 Type 2, duhet të jenë me një shtresë treguese të integruar me ngjyrë të paktën 10% të trashësisë së murit të tubit në pjesën e jashtme për të lejuar një vlerësim të saktë të sipërfaqes së tubit.

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë se materialit sipas PAS 1075 do të kryhet nga testimet, inspektimet dhe certifikimet e miratuara.

Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 50001.

Tub plastmasi te brinjëzuar me muftë

Tubat e brinjëzuar të polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLË 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

<i>Klasa e ngurtësisë</i>	<i>Vlerat e ngurtësisë së unazës</i>
<i>SN8</i>	<i>minimum 8 kN/m²</i>

Tubat duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523.

Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të tubave duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476. Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi 30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.

Tuba te brinjëzuar HDPE

Tubat e brinjëzuar të polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLË 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

<i>Klasa e ngurtësisë</i>	<i>Vlerat e ngurtësisë së unazës</i>
<i>SN8</i>	<i>minimum 8 kN/m²</i>

Tubat duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523.

Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të tubave duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476. Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi 30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.

Rakorderi HDPE

Rakorderitë e polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLË 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

<i>Klasa e ngurtësisë</i>	<i>Vlerat e ngurtësisë së unazës</i>
<i>SN8</i>	<i>minimum 8 kN/m²</i>

Rakorderitë duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523.

Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të rakorderive duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476. Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi 30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.

Zerat e Materialeve:

- Tuba plastik HDPE 100 DN 20 mm Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 25 mm Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 32 mm Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 40 mm Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 50 mm, Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 63 mm, Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 75 mm, Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 90 mm, Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 110 mm, Pn 10*
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 125 mm, Pn 10*

- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 160 mm, Pn 10
- Tub plastmasi te brinjezuar me mufte Ø 160
- Tub plastmasi te brinjezuar me mufte Ø 200
- Tub plastmasi te brinjezuar me mufte Ø 250
- Tub plastmasi te brinjezuar me mufte Ø 300
- Tub plastmasi te brinjezuar me mufte Ø 350
- Tuba te brinjezuar HDPE d=315 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=400 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=500 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=600 mm
- Rakorderi HDPE d=315 mm
- Rakorderi HDPE d=400 mm
- Rakorderi HDPE d=500 mm
- Rakorderi HDPE d=600 mm

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "LIQENI VII" ShPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formular vlerësimi nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Durrës ShA, me objekt: "Rikonstruksione në rrjetin ekzistues të Qytetit Durrës zona 14", me vlerë të realizuar 234,353,883.75 lekë me TVSH, shoqëruar me situacion nr. 6 përfundimtar dhe fatura tatimore.
- Formular vlerësimi nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Kamëz, me objekt: "Ndërtim KUN në rrugën 'Shebeniku', Laknas L=412ml, $\Phi = 315\text{mm}$, bashkia Kamëz", me vlerë të realizuar 1,677,840 lekë me TVSH, Situacion përfundimtar të punimeve me objekt "Ndërtim KUN në rrugën 'Shebeniku'", Laknas L=412ml, $\Phi = 315\text{mm}$.
- Formular vlerësimi nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Durrës ShA, me objekt: "Përmirësim i furnizimit me ujë lagjja Nr. 1, Vadardhë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës", me vlerë të realizuar 153,270,379.39 lekë me TVSH, shoqëruar me situacion përfundimtar dhe fatura tatimore.

III.1.4. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor argumenton se:

Në dokumentet e tenderit Shtojca 7, në pikën pika 2.3.1. është përcaktuar se:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të

deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 40% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, ankimesi ka paraqitur si dëshmi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) kontrata punimesh me objekt

- Rikonstrukcion në rrjetin ekzistues të qytetit Durrës Zona 14, 2022-2023.

- Ndërtim KUN ne Rrugën Shebeniku

- Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagjja Nr.1, Vadardhe 2020-2021.

Dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimes, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi kontratat e mësipërme janë kontrata punimesh dhe nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme në përputhje me kriterin e parashikuar në dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas përmbajtjes të nenit 40 "Kërkesat e veçanta të kontratave të mallrave", në pikën 4 ndër të tjera parashikohet: "4. Për të provuar përvojën e mëparshme...Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Siç shihet nga kjo dispozitë për të vërtetuar përvojën e ngjashme duhen këto dokumente;

a) Nga entet publike;

Vërtetim nga enti publik përmbushjen me sukses të kontratës së furnizimit

Ose/dhe fatura tatimore shitje për sasi të mallrave të furnizuara

b) Nga sektori privat:

- Fatura tatimore të shitjes

Nga ana e ankimesit nuk është dorëzuar as kontratë furnizimi, as faturë shitje për kontrata furnizimi në entet publike, si dhe faturë shitje nga sektori privat.

Kontratat me objekt: "Rikonstrukcione ne rrjetin ekzistues te qytetit Durrës Zona 14"; "Ndërtim KUN në rrugën Shebeniku, Laknas L412 ml f_i=315mm; "Përmirësim i furnizimit me ujë lagja NR.1, Vadardhë, njësia administrative Sukth Bashkia Durrës", jane kontrata punimesh dhe jo kontrata furnizimesh.

Po ashtu, autoriteti i ka shqyrtuar vlerat e faturave të punimeve për këto kontrata dhe në përfundim vlerësoi se këto kontrata plotësojnë elementin kohë afatin tre vjeçar, por për zërat e punimeve në këto kontrata (të vlerësuara të ngjashme) me numër analize, referuar manualit të çmimeve të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 është kryer zbritja e fuqisë punëtore dhe materialeve plotësuese të procesit të punës. Vlera e furnizimit të materialeve e llogaritur si me lartë, nuk plotëson vlerën 40% të fondit limit sikurse percaktohet në pikën 2.3.1 të Dokumenteve Standarde të tenderit (Loti 3) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Pretendimin e tij ankimesi e mbështet në kontratën e furnizimit me autoritetin kontraktor Ministria e Mbrojtjes "Blerje material për mirëmbajtje të përgjithshme" datë 12.9.2022, dorëzuar me formularin e ankesës. Nga verifikimi kjo kontratë nuk është dorëzuar në SPE nga ankimesi me ofertën e ekonomike, rrjedhimisht ky dokument nuk pranohet. Autoriteti shqyrton dhe vlerëson ofertën ekonomike vetëm bazuar në dokumentet e dorëzuara në sistemin elektronik të prokurimit. Çdo akt apo dokument tjetër që nuk është dorëzuar me ofertën në SPE, nuk pranohet.

KSHA gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Për sa më sipër pretendimi i OE ankimes "LIQENI VII" ShPK, nuk qendron pasi nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme një komponent shumë i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të autoritetit kontraktor.

Në mbështetje të Nenit 114 pika 3/c të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", neni 102 pika 1/ca të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të refuzojë ankesën e operatorit ekonomik "LIQENI VII" ShPK NUIS K01730502W për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur"- Marrëveshje Kuadër Loti 3 me Ref-74541-07-07-2023, me objekt: "Loti 3: "Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II", me fond limit 83,333,333 lekë pa TVSH.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Neni 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt - prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.8. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla duhet të

plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 40% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Për përmbushje të kriterit të mësipërm, ankimuesi ka paraqitur si dëshmi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) kontrata punimesh me objekt:

- Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të qytetit Durrës Zona 14, (2022-2023).

-Ndërtim KUN ne Rrugën Shebeniku (2021)

-Përmirësimi i furnizimit me ujë Lagjja Nr.1, Vadardhe (2020-2021).

Dokumentacioni i paraqitur nga OE ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi kontratat e mësipërme janë kontrata punimesh dhe nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme në përputhje me kriterin e parashikuar në dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas përmbajtjes të nenit 40 "Kërkesat e veçanta të kontratave të mallrave", në pikën 4 ndër të tjera parashikohet: "4. Për të provuar përvojën e mëparshme...Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Siç shihet nga kjo dispozitë për të vërtetuar përvojën e ngjashme autoriteti kontraktor ka kërkuar këto dokumente;

a) Nga entet publike;

Vërtetim nga enti publik, përmbushjen me sukses të kontratës së furnizimit

Ose/dhe fatura tatimore shitje për sasinë e mallrave të furnizuara

b) Nga sektori privat:

- Fatura tatimore të shitjes

Nga ana e ankimuesit nuk është dorëzuar as kontratë furnizimi, as faturë shitje për kontrata furnizimi në entet publike, si dhe faturë shitje nga sektori privat

Kontratat me objekt: "Rikonstruksione në rrjetin ekzistues të qytetit Durrës Zona 14"; "Ndërtim KUN në rrugën Shebeniku, Laknas L412 ml fi=315mm; "Përmirësim i furnizimit me ujë lagjja NR.1, Vadardhë, njësia administrative Sukth Bashkia Durrës", janë kontrata punimesh dhe jo kontrata furnizimesh.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" është parashikuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, **si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie.** Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që*

operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Pra e drejta e dhënë nga ligji, lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter mund të përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë objekt dhe natyrë të cilat nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të procedurës së prokurimit ka furnizimin me mallra. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat e mësipërme të paraqitura

nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1./a/b, të kapacitetit teknik.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “LIQENI” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “LIQENI VII” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me kushte të përcaktuara”, me nr. REF-74531-07-07-2023, me objekt “Loti 3: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II”, Loti 3: Ref- 74541-07-07-2023, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 Lek pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, kjo vlerë konvertohet në 791,089.16 Euro, zhvilluar në datën 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri

